



Pranimi i Ankesave Primesje/Prishti Primesje/Prishti	09.12.2021	1	Vite vite/years
Organizimi/Institucioni Organizacija/Institucija Organizacija/Institucija	SKR/SHK	5937/2021	116



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A nr.882/2021**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**- Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti –anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.882/2021 të datës 22.10.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë: Rruga "Shaqir Tërshani" Nr.56 , Komuna e Shtimes, kundër Vendimit KA.nr.52/2021 të datës 05.10.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 08.12.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

- REFUZOHET** si e pabazuar ankesa me numër A.nr.882/2021 e datës 22.10.2021 e parashtruar nga ankuesja
- MBETET** në fuqi Vendimi me numër KA.nr.52/2021 i datës 05.10.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

**A r s y e t i m**

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 20.05.2021 ka shpallur konkursin me Nr: 03/2021 për pozitën "Zyrtar Ligjor 1- në Gjykatën Themelore në Prishtinë-nëntë pozita" në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila është ftuar të marrë pjesë në testin me shkrim dhe intervistën me gojë mirëpo nuk është për zgjedhur si kandidat e suksesshme.

Më datë 20.08.2021 Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka bërë publik njoftimin për kandidatët e suksesshëm me numër:03/1394.

E pakënaqur me njoftimin e datës 20.08.2021, ankuesja më datë 17.09.2021 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 05.10.2021 nxjerr Vendimin me numër KA.nr.52/2021 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses.

Ankuesja kundër Vendimit me numër KA.nr.52/2021 të datës 05.10.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 20.10.2021 nëpërmjet postës ka parashtruar ankesë e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar me datë 22.10.2021 dhe numër protokollit 5142/2021 me pretendimet ankimore se procedura e rekrutimit lidhur me konkursin e lartë cekur është zhvilluar në kundërshtim me neni 3 paragrafi 2 dhe 9, nenin 11 paragrafin 1 si dhe neni 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe po ashtu neni 38 i Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil është zbatuar sipërfaqësisht.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.10.2021, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Sekretari i Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 15.11.2021 ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë me shkresat e procedurës së zhvilluar me provat e bashkangjitura të lëndës dhe është protokolluar me numër:5437/2021.

Në mbështetje të nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe duke marrë parasysh rrethanat e funksionimit të KPMSHCK-se, me Vendimin nr.62/2021 të datës 06.12.2021 të Kryesuesit të KPMSHCK-së është vazhduar afati për vendosje të ankesës me numër A.882/2021 të datës 22.10.2021 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 22.10.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 28.10.2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 15.11.2021; Vendimi me numër KA.nr.52/2021 i datës 05.10.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Ankesën e ankueses të datës 17.09.2021 të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Njoftimin për kandidatët e suksesshëm të datës 20.08.2021; Njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare të datës 20.08.2021; Propozimin për emërimin e kandidatit të rekomanduar i datës 20.08.2021; Raportin Final të rekomandimit nga Komisioni Rekrutues të datës 19.08.2021; Renditjen përfundimtare të kandidatëve i datës 19.08.2021; Raportin për përcaktimin e kriterëve për testim me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj të datës 16.08.2021; Regjistrin e aplikacioneve të pranuar; propozimin për emërimin e anëtareve të Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil i datës 22.07.2021; Vendimin për emërimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil të datës 22.07.2021; Ankesën e ankuesit të datës 17.09.2021 të parashtruar në KZKA; Vendimin KA.nr.52/2021 e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të datës 05.10.2021; Kopjen e shkresë së postës e datës 12.10.2021 dorëzimin e vendimit të KZKA-së; Vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave A.nr.52/2021 të datës 05.10.2021; Formularët për vlerësimin e testit me shkrim dhe me gojë i ankueses

Testi me shkrim i ankueses i datës 30.07.2021; Kërkesa për punësim e kandidatës i datës 28.05.2021; referenca numër Nr.02/2020 e datës 14.09.2021; Rekomandimin e datës e datës 25.05.2021; Kontratën e punës së ankueses të datës 03.01.2016; Diplomën e ankueses të datës 01.11.2018 me Nr:5898; Vërtetimin e kopjes nga origjinali e lëshuar nga noteri me datë 04.09.2020; Kontratën e punës së ankueses të datës 04.01.2019; Kontratën e punës së ankueses të datës 05.01.2018; Kontratën e punës së ankueses të datës 06.01.2017; Kontratën e punës së ankueses të datës 06.01.2016; Kontratën e punës së ankueses të datës 05.01.2015; Kontratën e punës së ankueses të datës 27.02.2014; Formulari për përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë të datës 23.07.2021; Konkursin e datës 20.05.2021; E-mailin e datës 20.05.2021 dërguar nga lidhur me njoftimin për konkursin Nr.03/2021; E-mailin e datës 04.06.2021 dërguar me korrespondencën e bashkangjitur prej pesë (5) faqesh; vendimin për emërimin e komisionit përzgjedhës i datës 21.07.2021; Lista e përgjithshme e kandidatëve për testim me shkrim për pozitën Zyrtar Ligjor; Regjistrin e aplikacioneve të pranuar në konkursin e datës 20.05.2021; Formularin e rezultatin e testeve me shkrim dhe me gojë për kandidatit Testi me shkrim i kandidatit Kërkesën për punësim e kandidatit e datës 27.05.2021; Diplomën e datës 24.07.2020 me Nr:2371 të kandidatit Kontratën e Punës të datës 10.02.2021; Kontratën e punës së kandidatit të përzgjedhur e datës 09.03.2020; Kontratën e punës së kandidatit të përzgjedhur e datës 01.06.2018; Akt emërimin e datës 18.10.2016; Çertifikatën e kandidatit

e datës 25.10.2017; Çertifikatën e datës 22.05.2021; Çertifikatën e datës 22.05.2019; Letër rekomandimin e lëshuar nga /NPL "Sport Marketing" sh.a; Letër rekomandimin e lëshuar nga Avokati Kopjen e letërnjoftimit të kandidatit Çertifikatën e lëshuar nga Givkata Themelore në Prishtinë për e datës 12.05.2021; pasqyra e trustit pensional për kandidatin Formularët e vlerësimit për testin me shkrim dhe me gojë për kandidaten Testin me shkrim për kandidaten i datës 30.07.2021; Kërkesën për punësim të kandidatës të datës 25.05.2021; Çertifikatën e datës 13.03.2017; Diplomën e datës 18.12.2015 të kandidatës me nr:1014; Diplomën e datës 31.10.2013 me nr:2161; Çertifikatën e datës 28.10.2015; Referencën e datës 09.10.2015; Letër rekomandimin e lëshuar nga Gjyqtar Referencën e datës 29.05.2021; Referencën e datës 12.10.2015; Çertifikatën e datës 29.11.2013; Vërtetimin e datës 23.05.2016; Kopjen e letërnjoftimit të kandidatës Çertifikatën e lëshuar nga Gjykatat themelore në Prishtinë për të datës 02.04.2021; Kontraten e punës të datës 27.02.2017; Kontratën e punës të datës 27.05.2017; Kontratën e punës të datës 01.01.2018; Kontratën e punës të datës 01.01.2019; Kontratën e punës të datës 01.06.2019; Kontratën e punës të datës 01.01.2020; Pasqyrën e llogarisë së trustit për kandidaten Formulari i vlerësimit për testin me shkrim dhe me gojë për kandidaten Kërkesën për punësim e kandidatës të datës 27.05.2021; kopjen e letërnjoftimit për kandidaten Diplomën e datës 26.10.2017 me nr:4991; Çertifikatën e datës 12.02.2019; Vërtetimin e datës 31.07.2020; Çertifikatën e datës 30.12.2020; Kontratën e punës të datës 01.09.2020; Rekomandimin e datës 08.02.2019; Letër rekomandimin e datës 31.07.2020; Testin me shkrim të kandidatës i datës 30.07.2021; rekomandimin e datës 23.09.2019 për kandidatin Diplomën e kandidatit me numër:2468 të datës 10.03.2014; Testin me shkrim të kandidatit i datës 30.07.2021; Formularin e vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë për kandidatin Kërkesën për punësim të të datës 24.05.2021; Çertifikatën e datës 06.07.2018; Çertifikatën e datës 21.10.2019; Vërtetimin e datës 16.11.2020; Marrëveshjen për shërbime të veçanta e datës 26.09.2019; Çertifikatën e praktikës e datës 04.04.2016; Kontratën e Shërbimeve lidhur ndërmjet Grupi për Studime Juridike-Politike dhe kandidatit të datës 03.06.2019; Letër rekomandimin e prokurores së shtetit Shkresën e lëshuar nga QKUK Prishtinë-Klinika ORL-së për kandidatin me numër:933; Raporti mjekësor lëshuar nga Poliklinika Akustika i datës 18.04.2018; Çertifikatën e lëshuar nga IKT për kandidatin Kopjen e letërnjoftimit të Formularin e vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë për kandidaten Testin me shkrim të kandidatës i datës 30.07.2021; Kërkesa për punësim e kandidatës e datës 02.06.2021; marrëveshja e datës 16.01.2017; Vërtetimin e datës 12.12.2019; Çertifikatën e datës 10.07.2018 për Çertifikatën mars 2017 për Çertifikatën e datës 31.10.2018 për Mirënjohjen e periudhës maj 2018; Kontratën e datës 30.07.2018; Kontratën e shërbimeve lidhur ndërmjet GLPS dhe kandidatës Testi me shkrim i kandidatës kopjen e letërnjoftimit të Diploma e kandidatës me nr:2545 e datës 18.03.2021; Diploma e kandidatës me nr:5706 e datës 19.09.2018; Çertifikatën e datës 02.06.2014; Shkresën e lëshuar nga Universitat Marburg të datës 21.07.2017; Çertifikatën e notave e datës 17.07.2018; Shkresën e lëshura nga Universitat Marburg të datës 04.01.2017; Çertifikatën e datës 31.03.2019; Kontratën e datës 20.04.2018 të kandidatës Kontratën e datës 01.04.2021; Raportin e punës të datës 01.04.2019; Kontratën e shërbimit të muajit shtator 2020; shkresën e English Language School e periudhës korrik 2020; Kontratën për shërbime të datës 03.09.2019; Kontratën për shërbime të datës 03.05.2019; pasqyrën e llogarisë së Trustit për periudhën kohore prej datës 01.08.2002 deri me datë 28.05.2021; letër rekomandimin e datës 01.04.2019; Çertifikatën e datës 31.01.2018; Çertifikatën e lëshuar nga YIHR për Mirënjohje e lëshuar nga UP "Hasan Prishtina" për maj 2018; Çertifikatën e datës 01-02.06.2021; Çertifikatën e datës 29.07.2020; Çertifikatën e datës 07-09.05.2021 lëshuar nga KOÇ University; Çertifikatën e lëshuar nga International Youth Conference për Çertifikatën e datës 06.04.2019; Çertifikatën e datës 30.11.2018; Çertifikatën e datës 17-19.09.20218 për pjesëmarrje në EU Summer School 2018; Çertifikatën e datës 15.07.2016; Çertifikatën e lëshuar nga Gjykatat Themelore në Prishtinë e datës 12.11.2020; Letër rekomandim e datës 18.11.2016; Çertifikatën e lëshuar nga English Language School për kandidaten Çertifikatën e datës 31.01.2020; Testin me shkrim të kandidatit i datës 30.07.2021;

Formularët e testit me shkrim dhe testit me gojë për kandidatin Kërkesën për punësim të kandidatit të datës 02.06.2021; Kopjen e letërnjoftimit të kandidatit Diplomën e datës 08.05.2019 me nr:6243; Çertifikatën e datës 18.02.2021; Çertifikatën e datës 06.09.2017; Mirënjohjen e lëshuar nga UP "Hasan Prishtina" për kandidatin Çertifikatën e datës 05.12.2017; Çertifikatën e datës 06.04.2018; Çertifikatën e datës 17.05.2018; Çertifikatën e datës 17.04.2018; Çertifikatën e datës 11.05.2014; Testin me shkrim të kandidatës të datës 30.07.2021; Kërkesën për punësim të datës 28.05.2021 të kandidatës Diplomën e me numër 7035 e datës 24.09.2020; Çertifikatë e datës 25.02.2021; Kopjen e letërnjoftimit të kandidatës Çertifikatën e lëshuar nga YIHR për kandidaten Çertifikatën e lëshuar me datë 02.05.2019; Çertifikatën e datës 31.05.2018; Çertifikatën e datës 28.12.2017; Çertifikatën e datës 06.09.2017 me Nr.91-4/2017; Kontratën e punës të datës 01.03.2021; Akt emërimin e datës 25.02.2021; Kontratën e shërbimit e datës 01.10.2019; Kontratën e datës 03.03.2018; Njoftimin datës 31.05.2017; Letër referencën e datës 25.04.2019; Letër rekomandimin e datës 08.07.2019; Letër rekomandimin e datës 29.06.2019; Formularët e vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë për kandidaten Referencën e datës 21.05.2021; vërtetimin e datës 26.05.2021; testin me shkrim të kandidatës datës 30.07.2021; Formularët e vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë të kandidatës të datës 30.07.2021; Kërkesa për punësim e kandidatës e datës 31.05.2021; Diplomën e datës 28.09.2017 me nr:4947; Akt emërimin e datës 16.10.2017; Çertifikatën e datës 26.11.2018; Letër rekomandimin e datës 16.10.2018 lëshuar nga Gjyqtari Vërtetimin e datës 01.11.2017; Çertifikatën e lëshuar nga DKA Prishtinë dhe CESES për periudhën shtator-dhjetor 2009; Çertifikatën për pjesëmarrje të datës 27.03.2017; Vërtetim pjesëmarrje e datës 10.03.2010; Mirënjohje e periudhës maj 2017 lëshuar nga UP "Hasan Prishtina"; Mirënjohje e datës 28.04.2009; Çertifikatën e datës 24.03.2006; Çertifikatën e datës 29.06.2007; Çertifikatën e datës 12.01.2007; Kontratën e punës të datës 18.10.2018; Kontratën e punës të datës 01.01.2019; Kontratën e punës të datës 01.01.2020; Formularët për vlerësimin e rezultateve të testit me shkrim dhe me gojë për kandidaten të datës 30.07.2021; testin me shkrim të datës 30.07.2021 i kandidatës Kërkesa për punësim kandidatës të datës 28.05.2021; Kopjen e pasaportës së kandidatës Diplomën e kandidatës të datës 07.09.2017 me numër:4876; Diplomën e kandidatës të datës 13.11.2017 me Nr-77/2017; Çertifikatën e datës 08.05.2019; letër rekomandimin e datës 23.09.2019; Vërtetimin e datës 19.03.2019; Vërtetimin e datës 16.12.2019; Referencën e lëshuar nga Gjyqtari Letër rekomandimin e datës 12.07.2018; Letër rekomandimin e datës 12.07.2018 lëshuar nga Gjyqtarja Referencën e datës 22.03.2019; Marrëveshjen për Shërbime të Veçanta e datës 26.07.2019; Ankesë kontratën e datës 05.11.2019; Ankesë kontratën e datës 28.01.2020; Çertifikatën e datës 24.06.2019; Çertifikatën e datës 11.04.2019; Çertifikatën e datës 07.02.2019; Çertifikatën e datës 27.03.2019; Marrëveshjen për angazhimin në masën e tregut të punës-praktikë në punë e datës 30.09.2020; Vendimin nr.62/2021 të datës 06.12.2021 të Kryesuesit të KPMSHCK-së.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankueses **është e pabazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit dhe analizimit të provave të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 20.05.2021 ka shpallur konkursin me Nr: 03/970 për pozitën "Zyrtar Ligjor I -në Gjykatën Themelore në Prishtinë-nëntë pozita", kodit LI/070 me koeficient 7, ndërsa si kritere të kualifikimeve arsimore dhe profesionale për këtë pozitë është kërkuar: "Diplomë Universitare-Fakulteti Juridik dhe Një (1) vit përvojë pune profesionale".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë analizimit të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankuesja me datë 25.05.2021 ka aplikuar në konkursin e lartë cekur dhe po ashtu e njëjta sipas Diplomës me numër:5898 të datës 01.11.2015 dëshkohet se i ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik të "Universitetit të Prishtinës" me datë 03.04.2015, ndërsa si i përket përvojës së punës e njëjta ka të lidhura kontrata të punës nga data 27.02.2014 deri me datë 03.06.2020 me Notere dhe konstatohet se ankuesja ka përvojë të punës mbi pesë (5) vite pas diplomimit. Po ashtu, me bazë të shkresave të lëndës të

administruara dhe të evidentuara në këtë vendim, të nëntë (9) kandidatët e përzgjedhur sipas njoftimit të datës 20.08.2021 për pozitën "Zyrtar Ligjor I në Gjykatën Themelore të Prishtinës" i kanë plotësuar kriteret e konkursit, kanë të mbaruar Fakultetin Juridik dhe kanë më shumë se një (1) vit përvojë pune pas diplomimit, andaj me rastin e përfshirjes në listën e shkurt sikurse të ankueses ashtu edhe të nëntë (9) kandidatëve të përzgjedhur. Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil neni 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 i cili ka përcaktuar se: "1. Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijmë: 1.1 Arsimimi dhe kualifikimi profesional: si dhe 1.2. përvoja e punës" pasi që ka vlerësuar drejtë përmbushjen e kriterëve të konkursit nga kandidatët e lartcekur.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesja në testin me shkrim ka arritur (51.5) pikë, andaj me rastin e ftesës për intervistim me gojë Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me nenin 36 paragrafi 2 ku përcaktohet se: "Kandidatët të cilët e kalojnë me sukses testimin me shkrim dhe arrijnë të mbledhin së paku 50 % të maksimumit të pikëve të përcaktuara nga KPSHC pranohen të hyjnë në testin me gojë...". Po ashtu, Kolegji gjatë analizimit të formularëve të datës 30.07.2021 në të cilët evidentohen pikët e testit me shkrim dhe vlerësimit të intervistës me gojë është konstatuar se ankuesja është vlerësuar nga të gjithë anëtarët edhe në fushën e kriterëve të përzgjedhjes siç janë: "Personaliteti dhe Planet Profesionale; Njohuritë e Përgjithshme Institucionale dhe Ekonomike; Njohuritë që Lidhen me vendin e Punës" siç përcaktohet edhe me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil neni 38 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 se: "Kandidatët të cilët kalojnë me sukses testimin me shkrim i nënshtrohen testimit me gojë, e cila përbëhet prej këtyre pjesëve: 1.1 Personaliteti dhe Planet Profesionale; 1.2 Njohuritë e Përgjithshme Institucionale dhe Ekonomike dhe 1.3 Njohuritë që Lidhen me vendin e Punës", andaj mbi bazën e këtyre fakteve Komisioni Përzgjedhës ka kryer detyrat e përcaktuara në nenin 7 paragrafin 7 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ndërsa pretendimi i ankueses se Komisioni Përzgjedhës ka zbatuar pjesërisht dispozitat e nenit 38 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil është i pa bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të Raportit të datës 19.08.2021 për renditjen përfundimtare të kandidatëve, ka konstatuar se kandidatja e përzgjedhur si më e vlerësuar është vlerësuar me 451.5 pikë, ndërsa kandidati i nëntë apo e fundit në listën e të përzgjedhurve është vlerësuar me gjithsej 385.75 pikë, ndërsa ankuesja si pikë të përgjithshme nga testi me shkrim dhe intervista me gojë në bazë të Formularit Form MAP-SHCK-08a ka arritur të grumbullojë gjithsej (258.75) pikë, me çka konstatohet se ankuesja nuk ka arritur pikë të mjaftueshme që të jetë në mesin e kandidatëve të përzgjedhur siç përcaktohet me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 të Rekrutimit në Shërbimin Civil neni 40 paragrafi 1 ku përcaktohet se: "Në shërbimin civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë".

Andaj mbi bazën e të gjeturave si më lart, Kolegji ka konstatuar se procedura e rekrutimit për pozitën "Zyrtar Ligjor I në Gjykatën Themelore në Prishtinë-nëntë pozita" e shpallur me konkursin Nr: 03/2021 të datës 20.05.2021 nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është zhvilluar në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit Nr.03-L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 11 paragrafi 1 i cili përcakton se: "Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësisë të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve" si dhe nenin 18 paragrafi 1 i të njëjtit ligji i cili përcakton se: "Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanshmëri të komisionit testues, mos diskriminimit e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës", ndërsa ankesa e ankueses është e pabazuar në tërësi dhe si e tillë është refuzuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit numër K.A.nr.52/2021 të datës 05.10.2021, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin

Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me A.nr.882/2021**

**Flakron GASHI**



*Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional*

**Esthet SHABANI**



*Kryetar i Kolegjit*



**Vendimi i dërgohet**

- Ankesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së